



Datë: 26.08.2025
Numër Protokolli: 5743/2025

A.nr.1193/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1193/2025, të datës 23.06.2025, të parashtruar nga ankuesi N.Q kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “Kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1193/2025, të datës 23.06.2025, të parashtruar nga ankuesi, N.Q.

A r s y e t i m

Ankuesi N.Q, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 23.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit përfundimtar me numër protokolli Nr.1953 të datës 28.05.2025, lidhur me kandidatin fitues për procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017398, për pozitën e punës, Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, të shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 01.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, më datë 07.07.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1193/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 24.03.2025, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00017398, për pozitën e punës Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, me mandat katër vjeçar, i hapur për aplikim nga data 25.03.2025 deri më datën 23.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej 8 kandidatë, ndër ta edhe ankuesi, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i njëjti i është nënshtruar fazës së vlerësimit profesional, ku në testin me shkrim ka arrit 40.2 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazat tjera të vlerësimit.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 28.05.2025 ka publikuar Njoftimin me numër protokolli Nr.1953, nga i cili njoftim rezulton se si kandidat fitues për procedurën përkatëse është shpallur kandidati R.H me 87.2 pikë.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar procedurën e rekrutimit me numër reference RN00017398, për pozitën përkatëse për shkak të shkeljes së të drejtës materiale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mbi pretendimin ankimor se përbërja e komisionit të pranimit ka qenë në kundërshtim me rregulloren për pranim në shërbim civil, përvoja e punës e kandidatit fitues nuk ka përvojë profesionale ashtu siç është kërkuar me konkurs, tutje shton se pyetjet e testit me shkrim kanë qenë në kundërshtim me procedurën e pranimit në shërbim civil, pasi që ka pasur dy tri opsione të njëjta. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa procesin e rekrutimit me Nr.RN00017398 ta anuloj në tërësi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati B.H, si kandidatë në procedurën e njëjtë të rekrutimit konkretisht rekrutimit me numër reference RN00017398, më datë 27.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshill kundër procedurës me numër reference RN00017398, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.1242/2025, të datës 25.08.2025, ka anuluar Njoftimin me numër protokolli Nr.1953, të datës 28.05.2025 për kandidatin fitues, ndërsa çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e verifikimit paraprak.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1193/2025, të datës 23.06.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1242/2025, të datës 25.08.2025, rrjedhimisht, ka anuluar Njoftimin përfundimtar për kandidatin fitues, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesi në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”. Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1193/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1193/2025, të datës 23.06.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1193/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, N.H;
- Udhëheqësit të Personelit në MBPZHR; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.